



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **27/2025**

Data: **03 prill, 2025. Ora: 11:00**

Vendi: **KQZ/ Prishtinë**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të pranishëm: Kurtis, Mufera Shinik

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Aktivitetet e Zyrës

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Zyrës për çregjistrimin e dy (2) partive politike: **PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME-PRN dhe SHPRESA DEMOKRATE-SHD**

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Çështje Ligjore

3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Ferizaj

4Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së: Kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e takimit, dhe nuk pati vërejtje, propozim të pikave të reja etj. Me 8 vota për, u miratua rendi i ditës.

2. Aktivitetet e Zyrës

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Zyrës për çregjistrimin e dy (2) partive politike: PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME-PRN dhe SHPRESA DEMOKRATE-SHD:

Besnik Buzhala, drejtor i Zyres: Bazuar me ligj, subjektet politike autorizohen që për cdo vit të dërgojnë deri më 31 mars, formularin e regjistrimit. Nga 54 subjekte të regjistruara, dy subjekte nuk e kanë dorëzuar formularin për vazhdimin e regjistrimit. Këto janë: PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME-PRN dhe SHPRESA DEMOKRATE-SHD.

Zyra, rekomandon për c’regjistrim. Këto dy subjekte, edhe ashtu janë të pezulluara për shkak se nuk kanë dorëzuar raportet e financimit.

Diskutuan: Ibrahim Selmanaj, Besnik Buzhala,

Me 7 vota për, dhe 1 kundër, u çregjistrimin këto dy subjekte.

3. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Ferizaj

Sami Hamiti: Këshilli, është takuar dhe ka shqyrtuar dy kërkesa: një Ferizaj, dhe në Skënderaj. Këshilli, ka shqyrtuar dokumentacionin, dhe bazuar në respektimin e ligjit, të rregullave kemi ardhur në përfundim se, duhet të bëhet ky zëvendësim. Ne, rekomandojmë për miratim.

Në Ferizaj, znj. Vanesë Sadriu, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Ferizaj, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës”, dhe e zëvendësuar anëtares e kuvendit komunal znj.Arbnore Salihu.

Në Skenderaj, znj. Egzona Genci nga subjekti politik PDK, e zëvendëson anëtare e kuvendit komunal Sala Jashari e cila, është zgjedhur deputete e Kuvendit në zgjedhjet e 9 shkurtit, 2025.

Me 8 vota për, miratohen që të dy këto zëvendësime.

Të ndryshme!

